

URDHËR
Nr. 2176, datë 26.11.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të gurmës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, germa “c”, e pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave znj. Kozeta Qehajaj, drejtores së Drejtorisë së Investimeve dhe Shërbimeve për sa vijon:

- për të trajtuar kërkesat për kopje dokumentacioni të dosjeve të punonjësve të ASHK-së dhe nënshkrimin e kthim-përgjigjeve të këtyre kërkesave;
- për të trajtuar dhe nënshkruar vërtetimet e punës për punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së.

2. Pavarësisht delegimit të kompetencave sipas këtij urdhri, drejtori i Drejtorisë së Investimeve dhe Shërbimeve, nëse e gjykon të nevojshme, mund t'i përcjellë për nënshkrim drejtorit të përgjithshëm shkresat që i vlerëson të një rëndësie të veçantë.

3. Delegimi i kompetencës, sipas këtij urdhri, nuk përfshin aktet administrative dhe detyrat të cilat duhet të miratohen dhe të ushtrohen nga drejtori i përgjithshëm, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”.

4. Në rast mungese në detyrë të drejtorit të Drejtorisë së Investimeve dhe Shërbimeve, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “c”, e Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë mungesës kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.

5. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1, të këtij urdhri, të ushtrohet duke filluar nga data miratimit të këtij urdhri deri në shfuqizimin e tij.

6. Ngarkohet Drejtoria e Investimeve dhe Shërbimeve dhe drejtori i tyre znj. Kozeta Qehajaj, dhe Sektori i Arkiv-Protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli